

VENDIM
Nr.596, datë 14.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA FRAKULL, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Frakull, të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 10 (dhjetë) dhe lidhja nr.1, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Frakull për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Për inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave										
Komuna: Frakull										
Fusha e përdorimit të pronës: pyje+kullota										
Nr. rend.	Nr.INV sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullusore (E.P.K)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja(sipas emërtesës popullore)	Nr . ngas.	Destinacioni	Sip.në ha.	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioin, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	75	Ek.Pyj.Levan	Barun	7/c	cung	3,75	mbrojtës	MMPAU	DSH.P Fier	
2	79	“	Perroi Peshtanit	8/a	sip.bim	14,5	mbrojtës	MMPAU	DSH.P Fier	
3	81	“	Brinjet e Peshtanit	8/d	sip.bim.	10	mbrojtës	MMPAU	DSH.P Fier	
4	98	“	Likovun	15/b	shkurre	17,4	mbrojtës	MMPAU	DSH.P Fier	
5	127	Ek.Pyj. Pesh-Cakran	Gurë Ftohta	8/a	cung	30,5	prodhues	MMPAU	DSH.P Fier	
6	130	“	Gurë Ftohta	9/b	sip .bimes	8,5	prodhues	MMPAU	DSH.P Fier	
7	132	“	Korie Pashajt	10	cung	25	prodhues	MMPAU	DSH.P Fier	
8	136	“	Burimi Sinanit	12/a	cung	6,5	prodhues	MMPAU	DSH.P Fier	
9	142	“	Burimi Sinanit	15/b	cung	23,6	prodhues	MMPAU	DSH.P Fier	
10	144	“	Gurë Ftohta	16/b	cung	5.5	prodhues	MMPAU	DSH.P Fier	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
75,79,81,98,127,130,132,136,142,144	Pyll	Në pronësi